



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 060/01-4178

Pejë, datë: 31 Janar 2025

PROCESVERBAL

Nga takimi i –I- i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **31 janar 2025** me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: pos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, z. Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtarë administrative znj. Donjeta Morina, asistente administrative, znj. Florlinda Berisha; përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 34 anëtarë prezent.

Nga të gjithë anëtarët prezent, me 32 vota pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

REND DITE

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 30.12.2024.
4. Shqyrtimi i i informatës së Komandantit të Policisë së Stacionit Policor në Pejë mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Pejës.
5. Shqyrtimi dhe miratimi pas diskutimit publik i draft Rregullores për Shërbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës.
6. Shqyrtimi i informatës së kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të Komunës së Pejës.
7. Shqyrtimi i informatës mbi planifikimin e Prokurimit për vitin 2025.

8. Shqyrtimi i informatës së kryetarit mbi planin e punës së ekzekutivit për 2025.
9. Shqyrtimi i informatës mbi raportin vjetor të Komunës së Pejës për vitin 2024.
10. Shqyrtimi i raporti informativ i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2024.
11. Shqyrtimi i raportit të KKSBB-së për vitin 2024.
12. Shqyrtimi i raporteve informative të Komiteteve Konsultative dhe komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës së Pejës.
 - a. Komiteti Konsultativ për Persona me Afësi të Kufizuara;
 - b. Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit;
 - c. Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik;
 - d. Komiteti për Shëndetësi;
 - e. Komiteti për Arsim dhe
 - f. Komiteti për Urbanizëm dhe Mbrojtjeje të Mjedisit.
13. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar;
14. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Në takim munguan z. Rrustem Berisha, z. Granit Kelmendi, dhe z. Rajan Arapi.

2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet

Nuk ka pasur.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të K.K. Pejë, dt. 30.12.2024.

Z. Labinot Panxha: dua ti paraqes vërejtjet e mia në lidhje me procesverbalin dt. 30.12.2024 në lidhje me ndaljen e fjalës. Këtu është e cekur që unë nuk mund të bëjë thirrje në emër të asambleistëve sepse përndryshe ta ndali fjalën. Është dashtë më e bë fjalën po ta ndali menjëherë dhe tu ka ndalë fjala. Këtu është dashtë më e cekë që ju ka ndalë fjala z. Labinotit dhe atë në mënyrë arbitrare, këtë e vërteton edhe pasëfolsi im Z. Berati që thotë nuk është në rregull më j'a ndalë fjalën dhe kështu po bini në kundërshtim me procesverbalin.

Kryesuesi Z. Rexhep Kurtbogaj: arsyja e ndaljes së fjalës ka qenë sepse ke qenë jashtë temës që e kemi pasur për diskutim dhe normal kur je jashtë temës duhet me ta ndalë fjalën sepse koha dhe limiti për më folë edhe anëtarët tjerë nuk mundësohet nëse folim jashtë temës.

Z. Labinot Panxha: prej kur e kam marrë mandatin e deri më sot asnjëherë nuk kam dalë jashtë rendit të ditës dhe gjithmonë kam qenë i kujdesshëm. Arsyja që ma ke ndalë fjalën, ndëgjohesh edhe në video incizim ku thua që ti nuk ke të drejtë më i bë thirrje asambleistëve që mos ta votojn një pike të caktuar, unë kam të drejtë aq sa keni ju. Nëse unë kam dale jashtë rregullorës apo jashtë ligjit, citone cilën rregullore e kam shkelur dhe jemi në rregull. Në të kundërtën kjo nuk duhet të bëhet si lloj praktike nga ana juaj sepse e dëmton shumë këtë institucion dhe po besoj shumë që nuk duhet të përsëritet.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 31 vota pro, 1 përmbajtur, kundër nuk ka, 2 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet procesverbali i K.K. Pejë, dt. 30.12.2024.

4.Shqyrtimi i i informatës së Komandantit të Policisë së Stacionit Policor në Pejë mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Pejës.

Kryesuesi Z. Rexhep Kurtbogaj: komandantin e policisë e kemi prezent z. Idriz Atashi, sipas planit të punës të kuvendit që e kemi diskutuar paraprakisht ne e kemi kërkuar një raport mbi gjendjen e sigurisë për një periudh një vjeqare.

Z. Idriz Atashi: fillimisht ju njoftoj që 178 oficer që janë në stacionin policor Pejë dhe dy nënstacionet janë me këtë kapacitet të cilët ofrojnë siguri edhe për të gjithë Pejën. Gjithsej vepra penale që janë trajtuar kanë qenë 1711 vepra për vitin që e lam pasë. Krahasimi final i gjithë këtyre veprave është që ne e kemi ngritë zbulshmërinë ku ne vitin 2023 ka qenë 71.4 ndërsa tash është 84.4, që do të thotë kemi kry shumë punë të mira sa i perket zbulshmërisë dhe gjetjes së kryerësve të veprave penale. Kemi ulur sa i përket vrasjeve krahasim me vitet tjera, mirëpo fatëkeqsisht i kemi pasur 3 raste të cilat janë trajtuar në zonen e përgjegjësisë tonë. Tentim vrasje kemi pasur 8 këto vepra nuk trajtohen vetëm nga policia por trajohen edhe nga instuicionet tjera, ku kyqen instuicionet e shëndetit mendor të cilat duhet të japin një kontribut sa më të madhë. Lendimet të lehta trupore kanë qenë 194, lendime të rënda trupore kanë qenë 14, të gjitha janë hetuar nga policia e kosovës në bashkëpunim me prokurorin dhe gjykatat dhe kryesit e këtyre veprave kanë marrë denimet e merituar. Veprat e narkotikëve është një dukuri që të gjithë jemi shqetësuar sepse është një rritje e këtyre veprave sa i perket perdorimit të narkotikëve nga rinia dhe nxënës të shkollave, edhe ne ju kemi përgjigjë gjithmonë me plane operative të caktuara të cilat kanë sjellë rezultat me kapjen e kryerësve dhe shitësve të narkotikëve pastaj edhe perdotsve. Mirëpo unë konsideroj që duhet të ketë një kontribut më i madh edhe nga instuicionet tjera edhe shkollave edhe edukimit familjar që keto vepra të zvoglohen dhe te kete sa ma pak vepra. Unë, si komandant gjithmonë propozoj se perveq punës policore që janë është edhe bashkëpunimi me juve dhe pikërisht është kjo që jemi bashkë sot këtu dhe e japim kontributin e përgjithëshem në sigurinë e vendit. Nese ne ofrojmë zhvillim, edukim, vende të punës, sport për të rinjët athere sigurisht që ky do të ishtet efekti i parandalimit të këtyre veprave siq janë veprat e narkotikëve. Uzupimi i pronës kanë qenë rastet e caktuara të cilat kanë ndodhë , kanë qenë diku 13 raste që janë trajtu me prokurorinë dhe policinë. Vjedhje kanë qenë 230 raste, 171 janë vjedhje të rënda që janë trajtu nga policia dhe Stacioni Policor Pejë. Grabitje kemi pasur 4 vepra mirëpo këto janë vepra që janë zbuluar menjehere, kryesit e veprave janë kap dhe ky është një sukses i policisë që të ketë parandalim të veprave. Monicion kemi kofisku 630 copë të kalibrave të ndryshme. Një dukuri që është vërejtë dhe është monitoru dhe kontrollu nga policia e Kosoves kanë qenë incidentet që kanë ndodhë nëper shkolla, por jo të gjitha në shkolla por edhe afër shkollave mirëpo janë konsideru si incidentet e të rinjeve që janë në shkolla duke vazhdu mësimin. Këto 56 raste janë trajtu përmes njësive të cilat i kemi dhe kanë aktivitete dhe prezencë para shkollave të cilët ofrojnë siguri. Aksidentet po ashtu janë një brengë dhe shqetësim i joni edhe te shofer të rinjë edhe të pa përvojës, edhe te infrastuktures janë disa elemente ktu që duhet me i trajtu! Policia e kryen punen e vet përmes kontrollave në trafik, matjes së shpejtësisë me radar të caktuar, tejkalimi i shpejtësisë edhe mos respektimi i shenjave të trafikut por 331 rate të aksidenteve janë shumë por me një plan i aprovum për 2025 ne zonen tone me pas sa ma pak aksidente.Ajo se qfare kam kerku shpesh është përkrahja e komunës për

sinjalizimin dhe besoj që kemi gjet një kordinim dhe ish dasht që këtë vit me u kordinu shenjëzimi i shenjave të trafikut i cili është shumë i shpeshtë, mendoj që duhet me qenë në vende të caktuara ku kish me pas sigurine me të madhe tek kalimtarët në qytetin tonë. Mirëpo në përgjithësi mendoj që ky vit do të ketë mundësi më të mira që policia me i realizu planet e veta dhe me zbatu ligjin e trafikut. Po ashtu mendoj që vitin 2025 do të jet vit i suksesit dhe komandanti e ka deren e hapur gjithmonë për ju për bashkpunime me institucionet që ta bëjmë Pejën sa më të sigurt dhe të kemi sa ma pak raste dhe sa më shumë punë të mira që kemi me i krye së bashku. Policia është në dispozicionin më të madh të mundshem për qytetarët.

Znj. Eleonora Bala: po më gëzon fakti që policia është shumë mirë e organizume, por mua po më intereson tek vjedhjet sepse jam provu shumë here me kanë hy hajnat në shtëpi, dhe në atë kohë nuk është zbulu asnje nga keto raste! Ju raportuat që kanë qenë 230 vjedhe dhe 171 vjedhje të rënda, dhe 4 grabitje. Më intereson sa prej tyre për afërsisht të ketyre rasteve janë zbulu, nese e keni këtë informacion?

Z. Idriz Atashi: ajo çka une kam mendoj dhe veprojt është se çdo rast duhet të trajtohet! Mirëpo sot çdo veper që kryhet, duhet të pajiset qytetari me raportin e viktimes ose kartelen e informimit të viktimes. Ku aty polici hetues e shenon emrin e ka numrin, dhe në çdo kohë qytetari ka të drejtë me u interesu për rastin. Në përgjithësi në stacioni policor i kemi kry 480 e disa raste të viteve ku unë nuk kam qenë komandant, dhe kemi raste të zbulimit të veprave që e cekta më lartë. Pako qu je jepet viktimave duhet me përcjllë rastin përveq në polici ka të drejtë edhe në gjykatë prokurori.

Z. Rajan Arapi: ju falenderoj për raportin me të vërtet një punë voluminoze nga ana e policisë së Kosovës Rajoni i Pejës. Megjithatë shqetësues me faktet që na i ofruat qoftë në aspektin e dhunës në familje, qoftë mbledhjen e monicionit, armëve pa leje realishtë shqetësuese! Por që e suksesëshme për policinë në identifikimin dhe në zbatimin e punës që është dasht me kry. Unë, e kam potencu në seancën e kaluar kur është diskutu për KKSBB-në, meqenëse është edhe drejtor i arsimit ka pas raste kur në shkolla ka pas kontrolla dhe tek fëmijet janë gjetur armët e ftofta. Kjo realishtë është bërë dukuri mjaftë e shpeshtë. Unë, e di që kujdestarët ose arsimtarët bëjnë kontrolla të her pas here, por mendoj që duhet të jet një bashkëpunim më i madh mes policisë edhe drejtorisë së arsimit që këto kontrolla të jen më të shpeshta. Ju kisha lut që kjo çështje të meret më seriozishtë nga policia e Kosovës, sepse dukuria apo fenomeni i rasteve të dhunës, terrorizmit në rajon është rritur, të mos e lejojmë që një gjë e tillë të ndodhë në Kosovë, por ta parandalojmë para se të ndodhë sespe kur ndodhë pastaj është vonë.

Z. Drin Veselaj: unë deshta me u ndal tek siguria në trafik, ketu mendoj që duhet të i kushtohet një rëndësi jashtëzakonishtë me me madhe se në të kaluarën. Për arsye se ne si institucione ta krijojmë një plan të moderitetit. Ju e cekta me heret se shenjëzimi i trafikut është shumë i rëndësishem dhe ne e dim që vendkalimi i këmbësorve është çdo 10 metra, i cili është i panevojshem dhe krijon rrezik për qytetarët. Sepse ligji e përcakton largësinë e këmbësorve vetëm me zbatu dhe atëherë kemi me ardh te një plan jashtëzakonishtë i mirë. Po ashtu ne duhet me bo përpjekje së bashku që ato të cilat janë të vërtetume shkenctarishtë që e rregullojnë komunikacionin me i vendos në funksion. Ne e dim që kryetari thotë se nuk na vyn semaforat, mirëpo në krejt botë është semafori që e zgjidhë problemin në komunikacionë. Kishte me qenë mirë, që edhe këtë pjesë bashkrishtë edhe me nivel qendror edhe komunal me bo një zgjidhje.

Për shkak se në qytein e Pejës kemi 2-3 pozicione që krijonjë tollovi dhe mendoj që me shlyrim e këtyre pozicioneve ne kishim mujt me arrit me pas një lëvizje më të shpejt dhe më të lirshme. Unë mendoj që ka shumë ekspert në komunës tonë dhe po ashtu në institucionin e juaj. që munden me bo këtë punë ndoshta edhe vullnetarishtë me jep një kontribut në këtë drejtim! Me sa e kuptova ju thatë që kenë 187 zyrtar policorë në nivel të vendit, a mjafton kjo duke pas parasysh që me regjistrimin e fundit janë dal mbi 80 mijë banor në qytetin tonë, a mjafton ky nr i policëve që me qenë kujdestar të sigurse së qytetarëve në komunën tonë?

Z.Islam Husaj: unë deshta me përshendet dhe me falenderu komandantin, për një raport të detajizuar për situatën e sigurisë në qytetin tonë. Unë jam i vetdijshëm se shumë nga aktivitetet të cilat kryen policia nuk mundet vetum me arrit sigurinë, por duhet edhe bashkëpunimi i institucioneve tjera. Posaqerishtë dhuna dhe problemet që ndodhin në shkollë, nuk mundet policia gjithmonë me zgjedhë këtë problem, por duhet familja fillimishtë në bashkëpunim me arsimtarët, bashkëpunimi me lagjen ku është shkolla për me mujt me zgjedhë një problem të tillë! Unë deshta vetem një pyetje, duke marr parasysh se ju i hartoni disa plane operative dhe gjatë hartimit të planit e parashihni edhe stafin i cili duhet me realizu një plan të tillë. Mirëpo duke e ditur situatën qysh e kemi në veri të brishtë, jeni të detyruar dhe obliguar që të bëni edhe stafin mbështets atje! A ju sjellë probleme dhe mungesa në planin e juaja operative këtu në vend? Dhe a planifikoni me i pas policët e lagjes? Sepse kemi nevoj me i pas dhe me përcjellë situatën në çdo lagje të qytetit. Faleminderit edhe një here për raportin dhe për bëni një punë të madhe.

Z.Feriz Gashi: edhe unë desha ta falenderoj komandantin për raportin e detajuar dhe e kam një pyetje për shkollën dhe mund të më përgjigjet edhe drejtori i drejtrisë së arsimit. Për mua është shumë shqetësuese kur u përmend përdorimi i subëstancave narkotike sespe përleshje nëper shkollën ka me pas gjithmonë. A keni statistika të sakta se sa është numri i nxënësve që përdorin substanca narkotike? Dhe ky nr i përdorusve a është më i lartë në shkollën fillore apo të mesem?

Z.Bujar Agusholli: unë e kam një pyetje për komandantin për djegjen e zyres informatike në Spitalin Rajonal Pejës të cilin e konsideroj si krim të organizuar dhe pasojat që kishin me ndodhë kanë qenë të paparapame! Sepse ajo zyre është mbi repartin e gjinokologjisë dhe naonatologjisë, dhe ende nuk e kemi asnjë raport në lidhje me ecurin se qka ka ndodhë edhe pse jam i vetdijshëm se janë shiku mbi 160 kamera, konsideroj që një akt i tillë për mua është akt terroristë. Ne si punotor të spitalit staf dhe as si qytetarë nuk kemi ende asnjë informacion, çfarë do qëllimi ka pas djegja e saj dhe nuk e shoh këtë si punë efektive të shërbimit policor. Sepse nuk e shoh të arsyshme që në këtë afat kohor mos me pas asnjë përgjegje asnjë informacio!

Z.Rrustem Berisha: si fillim ju përgëzoj komandant për sukseset dhe rezultatet e mira, ajo që mua më intereson është se ka të bëj me zhdukjen e ushtarit të UÇK-së me 25.03.2023 Samir Fuza. Unë e di që keni angazhime shumë por së paku të këtë një zgjidhje, se nuk dihet se qka ka ndodhë me atë ushtar, e di që trupi i tij është gjet vitin e kaluar por ende nuk ka rezultate dhe familjaret janë të shqetësuar dhe janë të interesuar me dit se qka ka ndodhë!

Znj.Fjolla Dembogaj: faleminderit komandant për një raport të detajuar unë kam shumë familjar që punojnë në polici dhe e di që puna juaj nuk është aspak e lehtë dhe faleminderit për punën që e bëni për qytetin tonë. Në fakt me vjen keq për rastet që janë në ritje në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa dhe ndihem mirë me rastet që janë zvogluar në krahasim me vitin e kaluar.

Pjesen e dhunës në familje shqetësuese është rritja e të dhunuarve, ndërsa më vjen mirë për faktin që janë vetdijesë dhe janë duke i raportuar keto raste. Meqenëse e ceket që ka polic nëpër shkollë, unë jetoj afër shkolles "Gjemaj Kada", dhe unë asnjëherë nuk kam pa polic afër shkolles mirëpo nuk dyshoj që veq jemi në siguri. Më intereson se a kemi drejtë në sikur policia me hi në shkollë me i kontrollu, a na duhet një leje ?

Z. Islam Husaj: unë nuk bëra asnjë fushatë por duke e dit që situata në veri është e brishtë, dhe e kemi obligim dhe detyrim me dërgu edhe staf tonë mbështetës në veri, a mund të ndodhë të kemi telashe në realizimin e planeve operative të cilat janë aprovu edhe janë caktu edhe stafi se kush ka me mar pjesë. Prandaj unë duke e dit numri e kufizuar të policisë sa mund të i realizohen planet që ka parapa policia vetem këtë e pyeta nuk është fushat por një realitet dhe deshta përgjegje.

Znj. Vjendita Kelmendi: ka probleme të natyres së tillë që në shkollë ka nxënës që mbajnë armë të ftofta, pyetja ime është direkte a ka ndonjë plan ose masë që të ndermeret për të sigurata një ambient për fëmijet në shkollë?

Z. Berat Ganiqi: deshta me u ndal ashtu siq u ndalen edhe parafolsit tek shkollë, jo vetem policia që të meret për nxënësit për mbajtjen e armëve të ftofta por të meret edhe policia e komunikacionit për shkak të zhvillimi të shpjetësisë të komunikacionit në këto rrugë ku qendrojnë shkollat. Ashtu siq i cek komandanti disa arsye të aksidenteve dhe këto aksidentet pa dyshim që kur ki mungesë të sinjalistikës atëherë ka me pas aksidente! Por unë komandant kisha dasht që njëjtë si në shkollë prania e policisë, të jetë edhe afër qendres së patent shoferit. Ku mas shumti dhe mas lehti janë duke e kaluar provimin, e kanë kalu provimin, dhe ndodhë korupcioni. Me vjen keq sepse vetem në Pejë kemi pas 1 mijë raste të falsifikimit dhe një aksion të tillë e mur policia në Prishtinë ku ndermari arrestimin e 10 personave. Po ashtu me vjen keq që shoh njerzë brenda policisë që shoqërohen me njerzë të tillë dhe janë aktivë me ata! Kshtuqë institucioni i policisë mos të përlyhet me keta persona, sepse 10 njerzë që kanë krijuar mbi 1 mijë njerzë tjera janë potencial ose me përfundu në burg ose me mbyt dikënd në komunikacion, nuk e meritojnë respektin e askujt dhe duhet të ndërmeren masa! Unë, e them haptas mendimin tim dhe me vjen keq kur shoh njerzë brenda policisë së Pejës që shoqërohen me njerzë të tillë, që pritet të akuzohen për një veper kaq të madhe penale dhe të rënd që mund të i kushtoj qytetit të Pejës.

Z. Nezir Jahmurataj: faleminderit komandant, që na jepen të dhënat për gjendjen e sigurisë në territorin e komunës së Pejës. Unë, i kam dy kërkesa që mundet me na ndihmu edhe ju edhe drejtori i sherbimeve publike. Vendet ku i keni për kalimin e këmbësorve janë fshi krejt ose me i hek ose me i bo të reja, se tash vera vin edhe mërgimtarët dhe vendkalimet me u pastru ma mire! Edhe patrollimet e policisë rreth qytetit mirë që i bëni dhe me i kontrollu njerzit që po enden me mjete dhe bartin mbeturinat nga shtëpia dhe na gjujnë në rrugët e lokalitetit në Pejë.

Z. Mentor Bajri: unë i kam dy kërkesa për qetësinë publike në qendren e Pejës sidomos gjatë veres personat me instrumente (tarabukë, tupan), kishte me qen mirë me i largu sepse po i jep qendres një pamje jo të hijshme. Kërkesa e dytë është për automjetet që po hynë në qarshinë e gjatë mbasi është ndalimi u hyrjes edhe shenja është e qartë, mendoj që duhet me ju mar patent shoferi.

Znj. Hidajete Nikqi: unë e kam një kërkesë që në vendet rurale policia e Kosovës të jetë më shumë evidente, sepse kemi raste të vozitjes nga adoleshentët që paraqesë rrezik për atë pjesë.

Z. Idriz Atashi: në përgjithësi janë qeshtje edhe shqetësime e jona dhe e gjithëve, mirëpo policia ideale është atëherë kur ka qytetari aktive. Po filloj me ju jep përgjien sa i përket sigurisë së shkollave është një shqetësim shumë i madh, mirëpo na nuk jemi shtet policor dhe unë nuk dua që si komandant me shkel integritetin e institucioneve arsimore. Unë dua me pa një rregullë që kanë me organizu stafi shkollor, mësimëdhënsat dhe prinderit dhe ky trekëndësh duhet me funksioni, sepse nese nuk funksionon ky atherë kemi me pas na probleme. Sa i përket sigurisë në trafik i kemi diskutu disa qeshtje policia është e gatshme me ofru përvojën e vet, pikat e nxehta ku jon dhe reziqet ku munden me ndodhë! Mirëpo duhet me kriju bashke me komunën një plan operativ po me ekspert të trafikut sepse edhe une jam mërzi me planin që është herën e kaluar. Mundemi e bo një plan të përbashket ekspertet e trafikut policia i jep rekomandimet e veta dhe është një ekipi trafikut i cili kujdeset për trafikun në qytet. Ajo se qka dua të them unë është bashkëpunimi dhe interesimi i të drejtat tona duhet të jetë maksimal nuk guxojmë me u ndal, nese e dim që diqka nuk o duke shku puna mbar. Ne duhet me rrujt me së par integritetin tonë në bazë të rregullave, ligjeve dhe dicitelines që e kemi na, mirëpo unë them qytetari ka të drejtë gjithmonë me adresu shqetësimin e vet ose për këdo qoftë. Sa i përket instrumenteve qetësisë publike unë duhet me angazhu dikend, dhe ai mundet me u dënu me ligjin mbi prishjen e rendit dhe qetësisë publike dhe duhet pajteter me j'a përcjellë patrullave si detyrë në terren. Për doktorin e kuptova shumë mirë pyetjen, sigurisht që të mer staf më shumë mirëpo na e kompenzojmë atë qeshtje me menagjim më të mirë deri sa të kalojnë në situat emergjente që me mujt me i kry detyrat të tjera sepse nese e kemi një prioritet nuk do të thotë që duhet punët e tjera me i lënë anash, policia duhet me funksioni përkunder prioriteteve që i ka, punojmë kah prioriteti dërgojmë staf të mjaftueshm dhe në anën tjetër organizojmë staf edhe për qytetin dhe vendet rurale. Tek qeshtjet e patent shoferit, përgjegjësia më e madhe është e prindit nese don me ja kalu provimin keq, pastaj po vin edhe gjërat e kqija në komunikacion. Në fund po ju them që do ta keni mbështetjen time 24 orë, respekt për të gjithë.

5. Shqyrtimi dhe miratimi pas diskutimit publik i draft Rregullores për Shërbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: është rregullore që e kemi shqyrtuar edhe në takimin KPF, gjithashtu është rregullore që ka dalë edhe në diskutim publik.

Z. Berat Ganiqi: rregullore e kemi shiku dhe mendojë që përmbajtja në një vend është gabim. Në nenin 11 paragrafi 3 thuhet që automjetit të cilit i vendosën bllokuesit duhet të paguaj gjobën sipas nenin 10 paragrafit 10.4, realisht nuk ka paragraf 10.4 por ka paragraf 1 dhe 1.4, andaj duhet të rregullohet kjo pjesë. Poashtu si LVV në fillim e kemi kundërshtu këtë punën më bllokues, më e mirë është marimanga kur dikush e dinë që i është marrë vetura komplet se sa vendosja e bllokuesve që në të kaluarën është përdorur vend e pa vend, andaj e kundërshtojmë këtë punë edhe është në kundërshtim me të drejtat e lirisë së njeriut.

Z. Islam Husaj: unë vetëm dua të tërheqi vërejtjen për një gabim teknik që është berë në materialin që ne e kemi marrë, në nenin 10 tek pika 1.1, tarifa e shepnzimeve është 30 me fjalë e shënuar ndësa në kllapa 35, duhet të rregullohet ky gabim teknik.

Z. Labinot Panxha: mbesim në qendrimet që i kemi dhënë edhe herave të kaluara në lidhje me këtë rregullore. Vërejtjet që i kemi paraqitur si duket nuk janë përfshirë hiç, aty ka jashtë zakonisht shumë gabime tek neni 10, ai nen i referohet rrugullimit të trafikut dhe rregullimin e trafikut e rregullon policia e Kosovës, nuk e rregullojnë inspektorët e as puntorët e komunës. Kjo rregullore unë besoj që vetëm do ti vështironte jetën e qytetarëve në komunën tonë, është e pa nevojshmë të nxjerrim një rregullore të tillë, andaj ne si AAK jemi kundër dhe do të kemi votën kundër kësaj rregullore.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: unë jam edhe më i kënaqur se ju mos me miratu rregulloren, por është kërkesë e policisë së Kosovës më pasë një rregullore me të cilën i marrin automjetet, sepse këto rregullore kanë qenë të dëmshme për komunën shumë. Për këtë arsye jam mundu me i heq nenet të cilat munden më i kërku para komunës për dëmet që ju bëhen. Për atë arsye e kemi ofruar tokën e komunës që mos të munden më i kërku komunës asgjë. Më i kënaqun kisha qenë këtë punë më përfundu policia vet por nuk po ja'u lejon ligji.

Z. Labinot Panxha: nuk e di kryetari a e ka lëxu rregulloren dhe a e din që qytetarëve kanë me ju blloku mjetet dhe automjetet në qytet, pra çka po zgjidhim ne me këtë punë? Edhe ligji e thotë që duhet me u zhblloku rrugët, unë mendoj që policia nuk të ka thënë siç po thu ti, policia është për më rregullu nëse ndodh një aksident ka mjete dhe mënyra si më i tërhekë ato automojete prej komunikacionit nuk është e domosdoshme komuna ta bëjë këtë zgjidhje. Nuk mendoj që një ligj i caktum e përcakton një çështje të tillë për me përfundu komuna.

Kryesuesi Z. Rexhep Kurtbogaj: brenda kësaj rregullore është standarte të jetë edhe kjo pjesa që e diskutum edhe më z. Berat, mirëpo tek koha e kontraktimit mundet që mos të jetë më operator kjo pjesa e bllokimit, por në rregullore është dashtë më e pasë edhe këtë pjesë sepse është rregullore standarte për të gjitha komunat në Kosovë.

Z. Berat Ganiqi: operatorët e marimangave gjithkund po kontraktohen nga policia, policia edhe mundet me ndryshu ligjin për shkakë që mundet me bë kërkesa në plan legjislativ për ndryshim, mirëpo dikujt i konvenon e dikujt jo, për shkakë që pazaret po bëhen më së shumti brenda disa institucioneve. Unë për këtë arsye në fillim ditën e parë kur ka ardh kjo rregullore kam thënë që të ceket unanimisht që zyrtarëve policor mos të ju ipet kjo kontratë e as familja e tij mos të zgjidhet operator, sepse keqpërdorimi më i madhë po ndodh këtu. Kur po janë këto lidhje në mes zyrtarëve dhe operatorit pastaj rezultatit po del fenomenal me bllokues siç e kemi pasur në të kaluarën.

Kryesuesi Z. Rexhep Kurtbogaj: Dy çështjet teknike të cilat duhen të rregullohen është shuma 30 euro dhe tek neni 11 paragrafi 3 është 10.4 duhet të jetë 1.4.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 19 vota pro, 1 përmbajtur, 11 kundër, 3 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet rregullorja për Shërbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës.

6.Shqyrtimi i informatës së kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të Komunës së Pejës.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: e keni përpara jush të hyrat kanë qenë të planifikuara 5.192.000 euro, kanë ardh në dhjetor dhe kanë kaluar diku me gjoba të trafikut dhe më këto donacione ka ardh 7.520.000 euro, rritja buxhetore është diku mbi 800.000 mijë euro. Në seancën tjetër këtë rritje buxhetore duhet më e bartë tek disa projekte për të cilat na është marrë buxheti vitin e kaluara dhe tash duhet më i mbulu projektet që kanë mbetë pa buxhet, përndryshe pjesën tjetër e keni të spjeguar të gjithën.

7.Shqyrtimi i informatës mbi planifikimin e Prokurimit për vitin 2025.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: materialin e keni marrë paraprakisht, plani i prokurimit, një plan më i detajuar nga buxheti i cili specifikon projektet konkrete.

Z. Naim Bytyqi: deshta me ngritë një çështje tek plani preliminar që ishte në muajin dhjetor i kam vrejtur disa ndryshime për të cilat deshta t'i ngris si çështje. Ndryshimi shumë për automjete në Kapeshnicë faza e dytë, te plani i prokurimit preliminar kanë qenë 20.000 mijë euro tash janë 200.000 mijë euro. Dhe tek raporti i punës së kryetarit janë poashtu 20.000 mijë euro. Pra këtë plan nëse e shohim me fokus dhe ndalemi tek investimet kapitale, në bazë të numrit rendor na dalin 24 projekte, mirëpo nëse i analizojmë mirë këto projekte situata na del keq. Nga 24 projekte 900.000 mijë euro shkojnë në pagesa për shpronetime, nuk shkojnë për investime të reja, 3 projekte tjera janë për renovime mbi 400.000 mijë euro. 1 projekt tjetër është mobilim rreth 80.000 mijë euro, 150.000 mijë euro asfalti rreth bizneseve. Kështu rreth 2.000.000 milion euro qytetarët e komunës së Pejës mundën me i gëzu nga ky plan i prokurimit. Është situatë shumë e pa qendrueshme, totali i këtij buxheti të planit të prokurimit është rreth 4.700.000 euro dhe vetëm 2.000.000 milion euro qytetarët mundën me i gëzu si projekte të reja prap po e përsëris.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: unë u mundova në pikën paraprake me ju tregu që komunës së Pejës 7.400.000 euro ju kanë marrë. Pikërisht të urra janë marrë 200.000 mijë euro dhe tash duhet me i kthy, sepse nuk mundet me u mbaru. Përndryshe me këtë rritjen buxhetore e mbulojmë buxhetin që na ka marrë përmbaruesi, dhe qeveria nuk e ka parë të arsyeshme që me e rimbursu sepse marrëveshjen me kontratën kolektive e ka bërë qeveria, nuk e ka bërë komuna.

Z. Drin Veselaj: sa i përket planit të prokurimit ne kemi qenë gjatë gjithë kohës këtu dhe e kemi parë se ato që janë planifikuar nuk janë realizuar në një masë shumë të madhe. Ndryshimi i këtyre planëve për ne nuk është më befasisht, mendoj që koncentrimi juaj si kryetar i komunës dhe ekzekutivit tuaj që në këto 6-7 muaj më shku në shtëpi, por kish qenë mirë me i përfundu projektet që janë filluar sepse shumica prej tyre si përshembull salla në Zahaq, që e keni nisur që 20 vite dhe prap janë paraparë parat për me vazhdu ajo. Kjo është kërkesë e imja që me u mundu këto mi mbyll e më pasë ka kush me u kujdes për projektet e reja.

Z. Berat Ganiqi: tek ura që është bërë ndryshimi i buxhetit aty tashmë ka dalë një pjesë pronë private. Kisha dashtë me e vërtetu a është pronë private, keni dalë edhe në gjykatë, nuk ka faj kryeministri që del pronë private dhe doni të ndertoni në pronë private ura!

8.Shqyrtimi i informatës së kryetarit mbi planin e punës së ekzekutivit për 2025.

Kryesuesi Z. Rexhep Kurtbogaj: kryetari paraprakisht e ka paralajmruar që në 11:00 ora duhet të dal. Më qenë prezent kish qenë më mirë, por është një material që është i dërguar nga anëtarët e kuvendit dhe mund ta diskutojmë këtu.

Z. Berat Ganiqi: e kishim diskutuar sikur të ishte prezent kryetari ose nenkryetari. Me kend me diskutu kush është bartës për punën e ekzekutivit. Nuk mundem me disku me drejtorja sepse këta janë përgjegjës për drejtorit e tyre. Në shenjë respekti për komandantin e policisë që ka ardh dhe po dojmë me e ndegu për raportimin dhe na obligon edhe vota e qytetarit se përndryshe as qendrimi jonë këtu është i pa nevojshëm, bile as drejtoreshen e financave nuk e ke prezente.

Z. Naim Bytyqi: ka të drejtë parafolisi, do të thotë i shtyjme këto dy pika, sepse pa qenë personi cili duhet të jap përgjegjësi nuk kemi pse me i diskutu.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: këto janë raporte informative që i keni marrë materialet dhe e keni të precizum mirë planin e ekzekutivit, kryetari nuk është prezent, ju çka keni më diskutu thuajeni tash, mund të diskutoni në kuvend.

Znj. Fjolla Dembogaj: edhe unë e di që është vetëm një informat mirëpo pajtohem plotësisht me dy parafolësit, nuk është aspak e drejtë që drejtorat nuk janë. Për kryetarin nuk kam asnjë vërejtje sepse asnjëherë nuk mungon, mirëpo nuk është e drejtë që drejtorat mungojnë, sepse kanë pika që diskutohen, nuk besoj që janë të pa përgaditur dhe mos më qenë të zotit, por pa marrë parasysh le të na respektojnë si asambleista.

Z. Labinot Panxha: sikur të ishte prezent këtu drejtori i çështjeve pronësore juridike ose kryetari, unë do e kisha pytur për raportin e tij. Ky drejtor e ka cekur që për ozurpimin e pronave komunale janë lëshuar dy gjoba në vlerë prej 1000 mijë euro dhe tjetra prej 500 qind euro. Unë e kisha pyetur cilat prona janë këto? A i keni liru apo vetem i keni denuar dhe këto vazhdojnë të jepen të ozurpuara? Tjetra thotë që kemi gjeneruar të hyra nga pagesa e qeras publike në vlerë prej 14.594.000 euro, thotë nga dhënja në shfrytëzim të pronës publike, i bashkon të gjitha parkingjet, kioskat, tavolinet. Pra të gjitha i ka bashku në një vend dhe e ka pru shumë prej 214.715 mijë euro. Unë mendoj që këto të hyra duhej të ishin vetem prej parkingjeve. Shtrohet pyetja për drejtorin a i gjeneroni të hyrat e parkingjeve publike ashtu siç parasheh kontrata sepse është shumë e rëndësishme?

Z. Drin Veselaj: drejtori i bujqësisë tha që Z. Drini ka qenë në komision për dhënen në shfrytëzim të parkingjeve, është e vërtet që kam qenë me një grup në komision dhe jam shumë krenar që e kemi bërë për herë të parë një punë të jashtëzakonshme, ku prej 70 operatorëve nuk

ka pasur asnjë ankesë, kështu që komisioni e ka kryer punën e vet, mirëpo ekzekutivi vazhdon të bëjë lojrat e veta, dhe nuk është e quditshme nëse ata nuk i paguajn ato parkingje.

Z. Islam Husaj: ju lutem të vazhdojmë me pikën që është më rradhë, nuk ka lidhje as parkingu, as mjetet e mbledhura nga parkingu në këtë pikë. Mandej po ankoheni pse po ma ndalë fjalën, jemi në pikën për planin e punës së ekzekutivit për vitin 2025, prandaj ju lutem të vazhdojmë më pikat e rradhës.

9.Shqyrtimi i informatës mbi raportin vjetor të Komunës së Pejës për vitin 2024.

Znj. Zike Hakaj Veselaj: unë jam ndalur të plani për shëndetsi, drejtori i kishte paraparë disa meremetime në ambulanca, për Raushiq e kish paraparë lyerjen e fasadës së jashtme por më të rëndësishmë e kemi gelqerosjen e objektit se sa fasadimin. Pastaj e kish paraparë funksionimin i kabinetit stomatologjik, kurse e kishte heq nga plani laboratorin hematologjikë. Në vitin e kaluar na ka premtuar dhe desha ta dijë arsyjen pse e ka heq nga plani? Sepse besoj që e meritojmë këtë laborator në bazë të punës që e kryejm dhe në bazë të numrit të pacientave që i kemi.

Z. Drin Veselaj: unë kisha kërku që në shënjë respektit ne me j'a kalu pikën komandatit të policisë, edhe ashtu ne u dakorduam të gjithë që nuk kemi pse me fol për këto pika kur njeriu i cili duhet me diskutu nuk e pat guximin me qendru, kish qenë mirë ata që na kanë respektuar ti respektojmë edhe ne.

10.Shqyrtimi i raporti informativ i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2024.

Z. Berat Ganiqi: singërisht është lutja e fundit që po e bëjm, kaloja fjalën komandatit sepse është një nder pikat e para, pikat tjetra ne mundemi edhe më u qu ju jeni pakic dhe mbeteni pa korum, si opozit e LVV nuk jam i interesuar me diksutu për asnjë pikë sepse ka shpenzime, ka me pak të hyra kënd me e pyetë unë? Mua me duhet drejtoresha ose kryetari i komunës.

Z. Naim Bytyqi: më të vërtet është e tepërt mos pjesëmarrja e zyrtarëve përgjegjës të drejtorive në seanca. Anjëhëro nuk është drejtoresha e financave, gjendja ekonomike është tepër e rënd në komunën e Pejës. 3.1 milion euro vetem këtë vit janë marrë nga denimet prej gjykatës dhe askush nga zyrtarët nuk e merr mundin me dalë me fol me tregu se çfarë po ndodhë.

11.Shqyrtimi i raportit të KKSBB-së për vitin 2024.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është një raport informativ nga KKSBB-ja që raporton për punën gjatë vitit 2024 i mbajnë 6 takime, njëri prej akterver kryesor janë komandanti dhe policia. Komandanti ke preznet dhe i shtjelloj shumë tema që ken për çështje të sigurisë. Raportin e keni mar paraprakisht, nese ka dikush diqka nese jo athere po kalojmë në pikën tjetër.

12.Shqyrtimi i raporteve informative të Komiteteve Konsultative dhe komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës së Pejës.

- g. Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara;

- h. Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit;
- i. Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik;
- j. Komiteti për Shëndetësi;
- k. Komiteti për Arsimit dhe
- f. Komiteti për Urbanizëm dhe Mbrojtjeje të Mjedisit

Të gjitha raportet informative të Komiteteve Konsultative dhe komiteteve tjera që janë prezentuar në senacë nga kryesuesit e komiteteve, i bashkangjiten procesverbalit dhe të gjitha janë në arhivën e kuvendit komunal Pejë.

13.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:

Nuk ka pasur.

14.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

Znj.Eleonora Bala: do t'i diskutojë disa çështje të shëndetësisë meqenëse jam e kësaj fushe. Në radhë të parë ka 1 muaj e më tepër që fletëpagesat e pacientëve bëhen me disa letra të thjeshta, dhe në këtë letër vendoset një vulë e institucionit, pra fletëpagesat mungojnë. Janë të shqetësuar edhe vet pacientet edhe personeli shëndetësorë. Pse ndodhë një gjë e tillë, pse nuk janë siguru këto fletëpagesa për këtë fillim vitë të ri që e kemi fillu me seriozitet dhe me neglizhencë të madhe. Sepse këto fletëpagesa të thjeshta munden edhe të keqperdoren, andaj kërkoj sqarim pse ka ndodhë një gjë e tillë? Çështja tjetër ndoshta dhe më e rëndësishme se para do ditëve në oborrin e QKMF-së janë grind dy punëtor shëndetësor, ku njeri e ka godit tjetrin me shufër metalik dhe për këtë as menaxhmenti dhe as institucioni nuk e ka diskutu këtë çështje dhe të ndërmeren masa disiplinore. Ndërsa në anën tjetër një infermiere në QMF 5 e kanë suspendu 6 muaj nga një konflikt verbal i cili mund të jetë shumë i pa rëndësishëm dhe njëherit është reziku edhe shëndeti i saj kur është lexu deklarata e shefit të saj i mirënjohur për trillime të tij sepse nuk është rasti i parë, dhe pyetja ime është se pse infermierja është suspendu për kurgjo e keta po përleshen dhe po e shuktin këtë punë? Unë, e di përgjigjen sepse menaxhmenti është i njejtës parti dhe i njejtës grup me interesa të përbashkëta edhe interesa dyshuse, dhe mendoj që duhet të rregullohet sepse kjo metoda që menaxhmenti i konsideron edukative përkundrazi e thellojnë hendekun e mos sigurisë dhe jo të mirë. Për fund një sqarim fondi që është nda 150 mijë euro për konsulencë mjeksore për çka është nda dhe a është duke vazhdu ai fond, sa mjete janë shpenzu për çka janë shpenzu, dhe për cilat destinacione?

Znj.Zize Hakaj Veselaj: edhe unë deshta me ngrit një çështje për shëndetësinë, ka dy muaj që në ambullant nuk i kemi terapia elementare, jeni duke ra keq para popullit ju dy partit që jeni në pushtet ktu edhe nelt, duke jep premtime të mëdha e nuk e keni një diklofen nëpër ambullanta.

Z.Labinot Panxha: unë i kam disa çështje por njëra ndër to është edhe që foli parafolsja për fletëpagesa dhe po qitet vula. Në lidhje me këtë e kisha parashtrur një shqetësim të cilin e kanë adresu oraganizata e Veteranëve të Luftes tek unë, fjala është për pacientet që shkojnë në Qkmf dhe ata i detyrojnë të paguajnë, ligji për kategoritë i liron nga pagesa edhe veteranët edhe të fëmijet e tyre, edhe dhuruesit e gjakut. Unë mendoj që duhet të ketë më shumë kujdes tek këto

kategori mos t'i detyrojnë të paguajnë sepse ligji i liron, kam bisedu edhe me drejtorinë e shëndetësisë dhe kam mar premtime nga ai që do të rregullojë këtë çështje dhe shpresoj shumë që këtë situatë do të zgjidhet. Çështja tjetër është banorët në fshatin Nepole janë duke u përball me vite në mungesë të energjisë elektrike si rezultat e atyre shtyllave të vjetruara. Unë, e di që nuk është në kompetencën e komunës të rregullojnë ato shtylla dhe rrjetin elektrik, por mendoj që do të duhet kuvendi komunal dhe kryetari i komunes të vizitoj ato fshatra dhe të njihet me problemin të cilin e kanë dhe të njëjtin të j'ua parashtoj pran operatorit ekonomik. Në raport të punës e pash që ish evidentu një kanal të ujitjes që është ndërtuara para pak muajve. Gjatë kësaj senace unë i mora disa fotografi nga banorët e fshatit Vranoc në rr.Cufë Krasniqi, një kanal i ujitjes që është ndërtu 200m i gjatë është demolu tërësisht. Pyetja ime është a është bërë pranimi teknik i kësaj pune, dhe nese po a jeni shku me pa se qysh është prish nga puna e keqe, dhe qfarë saknsione janë mar ndaj atij operatori që e ka ndërtu? Sepse këto janë taksa të qytetarëve dhe do të duhej të kishin kujdes me to dhe mos t'i qonin sa për sy e faqe apo për disa vota që dikush dikujta j'ua ka premtu.

Z.Berat Ganiqi: drejtoresha e DKRS-së po mungon, po ndoshta është duke na dëgjuar! Unë, kam pranuar shqetësim nga personat që i përdorin sallat ose objektet që janë nënkompetencën të DKRS-së. Ky shqetësim është se ata përpos që bëjnë pagesa me të holla në dorë, ata marrin si kompenzim një deftesë të pa vulosur dhe vetem me një nënshkrim të një zyrtarit brenda drejtorisë. Po ashtu pagesat janë të ndryshme dikush e paguan 50 euro dikush 150 euro dhe dikush lirohet nga pagesa. Nuk e di nese drejtoresha është në dijeni për këtë mirëpo marrja ose dhënja e parave kështu cash i një institucioni komunal përbën veper penale. Komuna e ka një xhirollogari ku duhet të bëhet pagesa mujore, dhe jo pa deftesa të pa vulosme dhe pa nr.fiskal dhe pa nr.biznesi vetem qellimi për qka përdoret. Unë ato pare nuk i kam pa të vendosura në raportime financiare, dhe pas zgjedhjeve kam me bërë kërkesën edhe zyrtarisht me pranë se sa ka pas të hyra dhe nese vertet ka ndodhë kështu le ta din që ka shkaktuar veper penale.

Z.Nezir Jahmurataj: pata një kërkesë për drejtorinë e arsimit kur lëvizin naten në fshatra dhe ne qytet e vërej që nëpër shkollat janë naten të gjitha dritat e ndezur, kisha kërku mos me shpenzu pa asnjë kontroll.

Znj.Arjeta Musliqi: deshta me ju përgjigjë dr.Zizë arsyja e mungesës së terapisë është se depoja e farmaceutike e shëndetësisë ka pas regjistrim. Ai regjistrim zgjatë në periudhën 15 tetor deri me 15 janar. Këtë here kemi mar terapi mirëpo nuk ka sasi të diklofenit. Procesi i përpunimit për terapi është bërë kërkesa, mirëpo mbas muajit shkurt me qyrra ka me pas diklofen. Sa i perket terapisë tjetër ma mer mendja që gjatë ditës vetem ju ka ardh sepse dje dhe pardje kemi mar. Po ashtu edhe për fletëpagesa ka mungesë, kërkesa është bërë kemi prit nuk ka ardh dhe nuk kemi pas tjetër zgjidhje. Problemi është vetem tek ambullantat e mëdhja sepse janë hargju, ndërsa ambullantat e vogla kanë sasi të mjaftueshme edhe të bllokave edhe të fletëpagesave. Ndërsa sa i perket veteranëve të luftës dy here e kemi dërgu kërkesën në ministri me email, dhe nuk kemi mar kurrfarë përgjigje! Sepse aty shkruan që veteranët janë të liruar mirëpo ceket qytetarët që nuk i respekton hinarkin e referimit kur i anashkalojnë ambullantat e veta dhe kur vini në qender të cilit nuk i takon atyre nuk lirohet asnjë nga pagesa.Mirëpo e presim përgjigjen e tyre dhe e rregullojmë edhe me rregulloren që kemi me bërë me drejtoratin e shëndetësisë edhe me zyren ligjore.

Z.Labinot Panxha: në piken e 7 të cilin po i referoshesh shkruan qytetarë, ndërsa në ligj për kategorinë e luftës shkruan veteranët, fëmijët e veteraneve, invalidet etj. Unë, po e kuptoj mirëpo

edhe ky është gabim për qytetarët të cilët nuk i refreohen! Po e mar një shembull psh. në fshatin Loxhë është ambullant deri në orën 13:00 punon, ndërsa qytetarit i dhëm dhëmbi ose veshi mbas orën 13:00, dhe ai në Loxhë nuk mundet me marr udhëzimin për me ardh. Pse ai duhet me i pagu 5 euro përderisa nuk mundet me mar në Loxhë udhëzimin për me ardh në një qender tjetër me mar sherbimin. Kam plotë raste që më kanë shkru që në Loxhë mbyllet ambullanta në orën smunden me mar sherbim, dhe ktu kur vin i shtin me pagu Kjo duhet me u rregullu. Ndërsa sa i perket kategorive të luftës si ken mbyllë ambullantat e tyre ata lirohen prej pageses si në spital si në ambullanta, lirohen ku don sepc ligji e thotë ashtu, udhëzimi mundet me shkru për qytetarët në përgjithësi por nuk e cekë veteran kategorit e veqanta për këtë arsye duheni me pas parasysh dhe me analizu mirë, ! Një gjë e di që ncse veteranët ose Organizata e veteranëve të luftës kanë me u ballafaqu me keto problem ata kanë me dal me dal me protestu me i qitë në rrugë ktu për diqka që ju njeh ligji,

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, krycsuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën 12:20 h.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalin zyrtarë në Youtube.

Kliko: <https://www.youtube.com/watch?v=B41kjWFOjf8>

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina



KRYESUESI I KUVENDIT,

Z. Rexhep Kurtbogaj